



# S T A T U T I

## I

### SHOQERISE AUSTRIAKE " KNAUF -TIRANA SHPK"

#### K R E U I

##### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

###### Neni 1

Shoqeria private austriake " Knauf - Tirana SHPK " ushtron aktivitetin e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire, te mbeshtetur ne kontraten dhe statutin e saj, ne legjislacionin tregetar shqiptar si dhe ne ligjet ne fuqi per fushat e aktivitetit te saj.

###### Neni 2

Themeluesit kane bashkuar kapitalin e tyre me qellim qe te nxjerrin fitime, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

###### Neni 3

Shoqeria " Knauf - Tirana SHPK" eshte person juridik me regjistrimin ne Gjykatën e Tiranës dhe fiton te drejtat per te ushtruar veprimtarine e saj me marrjen e lejes nga Zyra e Taktiveve te Rajonit perkates.

#### K R E U II

##### FORMA, EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

###### Neni 4

##### FORMA

Themeluesit kane krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHEK ), ne perputhje me Ligjin Nr.7683 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " si dhe me dispozitat e ketij statuti.

###### Neni 5

##### EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise do te jete " Knauf - Tirana SHPK "

Neni 6

SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, me adresen e perkoheshme : RR. "Siri Kodra", Pallati 79/1, Shk.2 Ap.16.

Me vendimin e Asamblese se ortakeve, sipas dispozitive te peroaktuara ne kete Statut dhe ne Aktin Themelues te Shoqerise, mund te hapen degje, zyra, filiale ose perfaqesi te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

Neni 7

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise ekonomike e tregtare i shoqerise eshte si vijon :

- Prodhim i materialeve te ndertimit.
- Prodhimi dhe perpunimi i gipsit dhe i produkteve te gipsit
- Furnizimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit dhe lendeve te para per te.
- Perfaqesimi dhe ndermjetesimi per lende te para, materiale ndertimi dhe sherbime te ndryshme.
- Kerkime shkencore gjeologjike.
- Veprimtari komisionere.
- Veprimtari transporti dhe krijim agjensise nderkombetare.
- Spedicion nderkombetar.
- Perfaqesim i shoqerive te huaja.
- Financime inzhinerike.
- Sherbime ekonomike, bujqesore, organizative e teknologjike
- Eksport dhe import i te gjitha llojeve te lendeve te para dhe te materialeve te ndertimit.

Neni 8

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje deri me 31 Dhjetor 2014, me perjashtim te rasteve, kur per shkaqe te ndryshme, kerkohet kohezgjatja ose prishja e parakoheshme e saj. Si dite fillestare meret data e rregjistrimit te saj ne Gjykaten e Tiranes.

**K R E U III**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,**  
**PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR**

**Neni 9**

**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke, i ndare ne 100 kuota. Vlera per qdo kuote eshte 1000 leke.

Ky kapital depozitohet ne nje nga bankat qe veprojne ne Tirane.

**Neni 10**

Ortakët kanë të drejtë që pjesët e kapitalit themeltar t'i transferojnë në rrugë trashëgimie ose personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, në marrëveshje midis tyre. Transferimet e kapitalit vërtetohen me akt noterial dhe behen me miratimin e asamblesë së ortakëve.

**Neni 11**

Brenda 30 diteve nga regjistrimi i shoqerise ne Gjykatën e Tiranës, organi drejtues i shoqerise do të përcaktojë sasinë e mjeteve të investuara si dhe llojin e madhësinë e kontributeve të secilit investitor. Shpërndarjen e fitimit dhe menyrën e përballimit të rreziqeve.

**Neni 12**

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me të gjithë pasurinë që ka të regjistruar.

**Neni 12**

**DREJTIMI ADMINISTRATIV**

Organi më i lartë drejtues i Shoqerise eshte asamblea e ortakëve. Asamblea eshte e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asamblea e zakonshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda katër muajsh nga mbyllja e bilancit dhe në rast të veçantë brenda gjashtë muajsh nga mbyllja e bilancit.

**Neni 13**

Asamblea e Shoqerise ka në kompetencat e saj që të caktojë:

- Rregullat e drejtimit të shoqerise.
- Planin dhe programin e veprimtarisë.
- Politiken tregëtare.
- Mbylljen e bilancit vjetor.



- Ndryshime ne organizimin.
- Mbylljen, likudimin, e shoqerise.
- Çeshtje te tjera, qe jane parashikuar ne rregullat e shoqerise.

Neni 14

Asamblea perbehet nga themeluesit e shoqerise. Ajo mund te marre vendime vetem me pjesemarrjen e me shume se gjysma e ortakeve dhe me te pakten dy te tretat e votave te ortakeve pjesemarres.

Neni 15

Themeluesi i shoqerise "Knauf - SHPK " Weisenbach/Liezen, Knaufstrasse 1, te perfaqesuar nga Manfred Winkler dhe Wilhelm Tochterle, per drejtimin e shoqerise "Knauf- Tirana SHPK" kane emruar kater administratore ortake:

- Zoti Richard Roeck, i cili eshte caktuar si administrator kryesor.
- Zoti Baldwin Alfons Knauf.
- Zoti Manfred Winkler.
- Zoti Nikolaus Wilhelm Knauf.

Neni 16

Themeluesit e shoqerise u japin kompetenca te pakufisuara, zoterinjeve administratore Manfred Winkler dhe Richard Roeck, per te perfaqesuar shoqerine brenda dhe jasht vendit.

Neni 17

MARREDHENIET FINANCIARE

Shoqeria mund te lidh kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona juridike ose fizike, vendas ose te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport - importin.

Neni 18

Shoqeria do te hape dy konte ne nje nga bankat qe veprojne ne Tirane. Nje konto me divize dhe nje konto me leke.

Neni 19

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore, etj.



Neni 20

Shoqeria ke te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj e anashjelltas, mund ta beje ne perputhje me kursin zyrtar ose me tregun e lire privat te valutes.

Neni 21

Per pasqyrimin e aktivitetit te shoqerise, administratori, persona te tjere te caktuar prej tij, eksperti kontabel, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

Neni 22

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin dhjetor te qdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilancin vjetor se bashku me deklaraten e te ardhurave te fitimit dhe te humbjeve dhe ti deponojte ato ne organin financiar te jurisdiksionit perkates.

Viti i pare i aktivitetit fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar ne Gjykatën e Tiranës dhe mbaron me 31 dhjetor te qdo viti.

Neni 23

Themeluesit e shoqerise detyrohen te mbulojne bilancin me humbje ose te njoftojne mbylljen e shoqerise.

Neni 24

Organi drejtues i shoqerise, nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbrituar humbjet e vitit te me pareshem, krijojne nje fond rezerve, te quajtur "rezerve e domosdoshme", me nje vlere te pakten ne masen 1/20 e fitimit. Kjo lenie menjan e fitimit nuk eshte e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrijn vleften e 1/10 te kapitalit themeltar.

K R E U  
IV

MARREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 25

Ortakët vendosin per shtimin ose pakesimin e numurit te punonjeseve qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise.

Neni 26

Marredheniet e punesimit rregullohen ne baze te kontrates qe lidhet lirisht midis paleve, ne perputhje me legjislacionin



shqiptar te punesimit. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise.

Neni 27

Kontratat e punes mund te lidhen me ose pa afat, sipas kritereve qe caktojne themeluesit e shoqerise dhe ne mungese te tyre sipas legjislacionit te punes. Kontrata permban te gjitha kushtet qe lidhen me pagat, shperblimet, kohen e punes, disiplinën ne pune, sigurimin shoqeror, pushimin etj.

Neni 28

Largimi nga shoqeria dhe transferimi ne nje pune tjeter behet ne base te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Dorezimi i detyres behet pasi te jene likuduar detyrimet materiale e financiare.

K R E U V

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 29

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore etj, kalojne ne pronesi te ortakëve dhe ndahen sipas kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 30

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page dhe rritje e perqindjes se fitimit vendosen nga themeluesit e shoqerise.

Neni 31

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas çmimeve qe cakton vete shoqeria per materialet qe do te tregetoje ose per shërbimet qe do te ofroje. Çmimet dhe tarifat caktohen sipas kërkesës dhe ofertës ne tregun ku ushtrohet veprimtaria.

Neni 32

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilin i jane zbritur ose shtuar shumat respektive te humbjeve ose te fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

Neni 33

SHPERBERJA E SHOQERISE



Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te pasqyruara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket mund te kerkojne ne Gjykaten e Tiranes prishjen e shoqerise.

Ne rast shperndarje te shoqerise, asamblea kujdeset per emrimin e nje ose disa eksperteve kontabel, likuidatore, te cileve u percakton edhe kompetencat per likudimin e shoqerise.

Pasuria qe mbetet mbas shlyerjeve te detyrimeve, ne rastet e perfundimit te shoqerise, u perkthet themelueseve te saj.

#### Neni 34

Mosmarreveshjet midis paleve dhe shoqerise, ne maredhenie me persona juridik e fizik, vendas ose te huaj, zgjidhen ne mirekuptim. Ne te kunderten, palet i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane.

#### Neni 35

##### DISPOZITA TE FUNDIT

Ortaket themelues, ne rast te shtimit te numurit te tyre ose te largimit nga shoqeria, si dhe ndryshime te tjera ne statutin e shoqerise, duhet te bejne ndryshimet e nevojshme ne organet gjyqesore dhe administrative.

#### Neni 36

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet ligjit per Shoqerite Tregetare, Kodit tregetar te Republikes se Shqiperise si dhe akteve te tjera ligjore te legjislacionit shqiptar.

#### Neni 37

Statuti perpilohet ne 4 kopje orgjinale per tju dorozuar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise "Knauf - Tirana SHPK".

Statuti perpilohet ne gjuhen shqipe dhe perkthehet ne gjermanisht me akt noterial. Permbajtja e statutit dhe e aktit themeltar ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen gjermane jane te barasvlefshme.

U nenshkrua ne Tirane, sot me daten 16.3.1995



THEMELUESIT

" KNAUF - SHPK "  
8940 Weissenbach / Liezen

Drejtore tërëgjyeshme Manfred Winkler      Ing. Wilhelm Toechterle

Te dy të përfaqësuar me prokurorë noterialë nga

Zoti Richard Roeck

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA TIRANE

Nr. 2818 Rep.

Nr.        Kol.

VERTETIM

Vertetohet se sot me datën 16.03.1995 u paraqit personali i shtetasi austriak Richard Roeck, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurua nga pasaporta me Nr. Y 0085216, madhor, me zotësi të plote për të vepruar, i cili deklaroi se statuti është hartuar jashtë kësaj zyre, me vullnetin e tij të lire e të plote dhe e nënshkroi për mua. Duke qenë konformë ligjit unë e vertetoj atë.

NOTERE



Shpresa Spahiu